



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:155274

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04961287

P.nr.3587/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/L.nr.542/20, të datës 13.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 10.11.2023, të hapur për publikun, në të cilën prezent ishin prokurorja e shtetit Elza Bajrami, i akuzuari F.K. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. E.L., me datë 13.11.2023, morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.11.2023 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari F.K., nga babai E..., dhe nëna K..., e gjinisë F..., i lindur me datë ..., në ..., me vendbanim në rrugën “...”, lagjja e ....., i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion fizioterapeut, i punësuar në QKUK, me gjendje të dobët ekonomike, student i Fakultetit të Mjekësisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal .....

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 08.11.2020, rreth orës 10:45, në Prishtinë, në rrugën “Astrit dhe Arbnor Dehari”, i pandehuri ka ndal veturën dhe posa ka dal jashtë, në një distancë 10-15 metra, ka shtënë me armë në drejtim të veturës në të cilin ishte i dëmtuari B.B. dhe më pas niset në drejtim të të dëmtuarit, e hap derën nën kërcënimin e armës, duke i futur armën në fyt dhe duke i thënë “të q.. robt të mbys”, e qëllon me kondak të armës në kokë dhe me këtë i shkakton lëndime trupore si

ndrydhje me plagë shqyrëse – ndrydhëse të indeve të buta të regjionit uror të kokës të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit mbretës, ku si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm për shëndetin

- Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par 1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 17, 38, 40, 42, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës të akuzuarin e lartcekur:

#### E GJYKON

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 ( një) viti e 6 ( gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 3 (tre) viteve nuk kryen veprë tjetër penale.

II. I dëmtuari B. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

IV. Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30€ (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

#### A R S Y E T I M

##### -Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 14.01.2021, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.I.nr.542/2020, të datës 13.01.2021 kundër të akuzuarit F.K. nga Prishtina, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së si dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda ka nxjerr aktvendim me numër PKR.nr.9/21 të datës 13.12.2021 me të cilin e ka veçuar procedurën ndaj të pandehurit F.K. vetëm sa i përket veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së. Gjyqtarit të çështjes, lënda i është caktuar me datë 12.10.2023 i cili edhe ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për caktimin dhe mbajtjen e seancës fillestare.

Me datë 10.11.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Elza Bajrami, i akuzuari F.K. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. E.L., ndërsa në këtë seancë nuk ka prezantuar i dëmtuari edhe pse i njëjti ka qenë i njoftuar për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së kësaj seance. Në këtë seancë prokurorja e shtetit para leximit të aktakuzës e ka precizuar dispozitivin numër 4 të aktakuzës sa i përket datës, kohës dhe vendit të kryerjes së veprës penale, dhe e ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç ‘rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

#### -Vlerësimi i pranimi të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas konsultimit me mbrojtësin e tij, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

#### -Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si

në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj veprë penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, ka kërkuar falje për veprimet e tij dhe se ka premtuar se nuk do të kryej më vepra tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti të kaluarën penale për të pandehurin ku i njëjti edhe më parë kishte qenë i dënuar me aktgjykime të formës së prerë. Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale.

-Vendimi për kërkesën pasurore juridike-

Konform nenit 462 par. 2 të KPPRK-së pala e dëmtuar është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin

për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.3587/21, me datë 23.11.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues

Dibran Jusufi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.